Menaxher projekti: Dr. Gothárd Csaba
Ndryshon orari i hapjes së magazinës së rrugës Szondi: H-P: 10:00-21:00
Drejtoria Qendrore e Budapestit:
1183 Budapest, Nefelejcs u. 9–11.

E-mail: flpbudapest@flpseu.hu
 Tel.: +36-1-291-8995, +36-70-436-4288
 Drejtor gjeneral: Dr. Milesz Sándor
 Drejtor i ekonomisë: Kádás Rudolf
 Tel.: +36-1-291-8995/103
 Drejtor i financës: Rókasné Véber Gabriella
 Tel.: +36-1-291-8995/171-es mellék
 Drejtor kontroli: Suplicz Zsolt
 Tel.: +36-1-291-8995/181
 Drejtor i Informatikës,
 Llogarisë dhe Çështjeve
 Ndërkombëtare: Ladák Erzsébet
 Tel.: +36-1-291-8995/160
 Drejtor i çështjeve të sigurisë dhe personelit:
 Huszti Bernadett Tel.: +36-1-291-8995/194
 Drejtorja Qendrore (Sekretaria):
 Geró Zsuzsa +36-1-291-8995/158,
 mobil: +36-70-436-4272
 Kismárton Valéria me kodin 107,
 mobil: +36-70-436-4273
 Petróczy Zsuzsanna me kodin 106,
 mobil: +36-70-436-4276
 Vida Mónika me kodin 159,
 mobil: +36-70-436-4278
 • Drejtoria Rajonale e Debrecenit:
 4025 Debrecen, Erzsébet u. 48.
 tel.: +36-52/349-657, +36-70-436-4286
 Drejtori i rajonit: Pósa Kálmán.
 • Drejtoria Rajonale e Szegedit:
 6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25.
 tel.: +36-62/425-505, +36-20/251-1712
 Drejtori i rajonit: Radóczy Tibor
 • Drejtoria Rajonale e Szekesfehervarit:
 8000 Szekesfehervár, Sóstói út 3.
 tel.: +36-22-333-167, +36-20/467-8603
 Drejtori i rajonit: Kiss Tibor

Forever Resorts

- Hoteli Këshjtjella e Szirakit
3044 Szirák, Petőfi u. 26.
tel.: +36-32-485-300,
fax: +36-32-485-285.
Drejtoresha e hotelit:
Király Katalin
Faqja e internetit:
www.kastelyszirak.info

Të nderuar punonjës!

Direktiva e re e vitit 2010 e BE-s me emrin „ndryshime të TVSH-s” hyri në fuqi nga data 1 janar 2010. Në këtë gjendet rregullorja e re e llogaritjes dhe deklarimit të TVSH-s së shërbimeve të bëra ndërmjet kufijve brenda BE-s. Përshembull një bonus që vjen nga një shtet tjetër anëtar i BE-s konsiderohet si një shërbim i tillë në aspektin e TVSH-s. Por kjo direktivë nuk ka efekt financiar mbi bonusin Tuaj. Nëse ju nuk keni të ardhura nga bonuse të ardhura nga shtete të tjera të BE-s, atëherë nuk ke asnjë lidhje me këtë.

Rregulli i ri duhet të merret parasysh vetëm në rastin e bonuseve të ardhura nga shtete të tjera të BE-s!

Nëse ju keni të ardhura të tilla, atëherë ndryshimet prekin çështjet e mëposhtme:

1. Forma dhe përmbajtja e çekut të bonusit
2. Detyrimi i deklarimit të TVSH-s në vendin ku jetoni

Ashtu si në rastin e çdo direktive të BE-s, edhe në këtë rast zbatimi i saj varet nga shteti përkatës. Kjo do të thotë që shtetet anëtare të BE-s mund t'i zbatojnë në mënyra të ndryshme këto rregulla. **Kështu që rekomandohet të kontaktoni me zyrën e FLP-s së çdo shteti të BE-s prej të cilit keni marrë bonuse nga data 1 janar 2010.**

Nëse ju zotëroni numër tatimi të nevojshëm për deklarim TVSH-je brenda BE-s, atëherë këtë numër do e kërkojnë edhe zyrat e tjera të FLP-s, dhe përveç kësaj duhet të ndryshoni edhe deklarimin e TVSH-s në vendin ku jetoni. **Ju rekomandojmë të kërkonte me çdo kusht mendimin e noterit dhe këshilltarit tuaj të taksave dhe tatimeve në lidhje me këtë temë.** Nëse ju nuk zotëroni numër tatimi të BE-s, edhe në këtë rast duhet të kontaktoni me çdo kusht me zyrën e FLP-s së shtetit të BE-s nga i cili merrni bonuse! **Gjendja juaj personale e tatimit ndikon shumë në faktin që si mund t'ua përshtateni kriteret e reja të TVSH-s. Ju rekomandojmë shumë që të kontaktoni sa më shpejt me noterin tuaj.**

Përshëndetje: drejtorja e FLP-s

NJOFTIMET E ZYRAVE JUGLINDORE



SERBIA

Zyra e Beogradit: 11010 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381 11 3970 127. Orari i hapjes: të hënën, të martën dhe të enjten 12.00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9.00-16.30, të shtunën e fundit të muajit dhe gjatë Ditës së Suksesit në orën 9.00-13.00.

Zyra e Nishit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 13/1., tel.: +381 18 514 130, +381 18 514 131.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 11.00-19.00, në ditët e tjera të punës 9.00-17.00, të shtunën e fundit të muajit dhe gjatë Ditës së Suksesit në orën 9.00-13.00.

Drejtori i rajonit: Branislav Rajić.

Numrat i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Biserka Lazarević dhe dr. Predrag Lazarević:
+381 23 543 318

Të martën në orën 13.00 16.00 dhe të premten në orën 14.00-16.00 presin thirrjet tuaja për konsultim.



MALI I ZI

Zyra e Podgoricës: 81000 Podgorica, Serdara Jola Piletića 20, tel. +382 20 245 412, tel./fax: +382 20 245 402.

Orari i punës: të hënën: 12:00 – 20:00. Në ditët e tjera të punës: 9:00 – 17:00. E shtuna e fundit e çdo muaji është ditë pune. Orari i punës: 9:00 – 14:00.

Drejtori i rajonit: Aleksandar Dakić

Numri i telefonit i specialistes mjek:

Dr. Laban Nevenka: +382 69 327 127



SLLOVENIA

Zyra e Ljubljanës: 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 3., tel.: +386 1 562 3640.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.

Adresa e magazinës së Lendavait: 9220 Lendava, Kolodvorska 14., tel.: +386 2 575 12 70, Fax: +386 2 575 12 71, e-mail: forever.living@siol.net. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00.

Orari i hapjes së zyrës së Lendvait: 9.00-17.00 në ditët e punës.

Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Numri i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Arbeiter Miran: +386 4142 0788



KROACIA

Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Trakošćanska 16, tel: +385 1 3909 770; Fax: +385 1 3909 771

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten: 09.00–20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00–17.00.

Zyra e Rijekës: 51000 Rijeka Strossmayerova 3/A.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten: 12.00–20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00–17.00

tel: +385 51 372 361, +mobil: +385-91/455-1905

Drejtori i rajonit: Dr. Laszlo Molnar

Numri i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Ljuba Rauški Naglic, mobil: 091 51 76 510

Në ditët teke në orarin 16.00–20.00.



SHQIPËRIA

Zyra e Tiranës: Tiranë, Reshit Collaku 36, tel/fax: +355 42230 535.

Drejtori rajonal: Attila Borbáth

Drejtori i zyrës: Xhelo Kiçaj, tel/fax: +355 694 066 811.

Kontaktim: në ditët e punës 9-13, 16-20,

e-mail: flpalbania@abcom.al



BOSNIA-HERCEGOVINA

Zyra e Bijelinës: 76300 Bijeljina, Trg D. Mihajlovića 3., tel: +387 55 211-784, +387 55 212-605, fax: +387 55 221 780.

Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-17.00.

Drejtori i rajonit: Dr. Slavko Paleksić

Zyra e Sarajevës: 71000 Sarajevo, Akita Šeremeta do br. 10., tel.: +387 33 760 650, +387 33 470 682, fax: +387 33 760 651.

Orari i hapjes: të hënën, të enjten, të premten: 09.00–16.30, të martën, të mërkurën: 12.00-20.00. Në çdo të shtunë të fundit të muajit (ditë pune) organizojmë një Ditë Suksesit mini në zyrën e FLP-s.

Drejtoresha e zyrës: Enra Hadžović




KOSOVA

Pristinë Rr. Uçk br. 94.

tel.: +381 38 240 781, +377 44 50 3911



A photograph of a man and a woman sitting outdoors. The man is standing behind the woman, smiling, with his arms crossed. He has a mustache and is wearing a patterned short-sleeved shirt. The woman is sitting in a chair, smiling, wearing a bright pink long-sleeved shirt. They are in a lush green environment with trees in the background.

**NJË GRUA SIMPATIKE,
DINAMIKE, SUGJESTIVE DHE E
VEÇANTË, DHE NJË NJË BURRË
I QETË, I SIGURT DHE I QESHUR.
KY ËSHTË ÇIFTI IDEAL MLM?
DIÇKA E TILLË. ÇIFTIT SIKLOS U
DOLI ME SUKSES RECETA. EDHE
FAMILJEN E NDËRTOJNË ME PO
AQ SUKSES SA EDHE RRJETIN.**

SIKLÓS ZOLTÁN DHE SIKLÓSNÉ DR. RÉVÉSZ EDIT

Nënta nuk është shumë e mirë

Edit, videot e leksioneve të tua në faqen e Forever-it janë ndër ato që shkarkohen më shumë.

Edit: Vërtet? Nuk e dija.

Ti nuk merr reagime?

Edit: Sigurisht që mar, por më shumë nga anëtarët e skuadrës sonë. Kurse sa të tjerë i shikojnë, i dëgjojnë dhe sa i pëlqejnë leksionet, kjo është e vështirë të matet. Në aktivitete më flasin shumë njerëz, por është e vështirë të thuhet që në këtë rast çfarë u jep shtytje, personaliteti im, përvoja 11 vjeçare në profesion apo thjesht ma njohin emrin.

Kjo s'ka qenë gjithmonë kështu, për shumë kohë jo vetëm që nuk dilje në skenë, por edhe ndërtimin e biznesit e bëje në mënyrë instinktive.

Edit: E gjitha nisi jo si biznes. Në vitin 1999 gjatë pushimeve në Dominikë u njohëm me Miki Berkics-in, sponsorin tonë të ardhshëm. U bëmë miq të mirë, por atëherë nuk e kishim idenë se me çfarë merrej. Nuk filloi menjëherë të na fliste rreth produkteve apo mundësisë së biznesit. Si përfundim ishin produktet ato që na tërhoqën. Pasi në fillim nuk kishim shumë besim tek MLM-ja, madje ishim betuar që nuk do të merreshim më me diçka të tillë.

Përse?

Edit: Kishim punar më parë në rrjete të tjera, edhe me Zolin aty u njohëm. Ai atëherë ndodhej në nivel të lartë, kurse unë isha shumë poshtë, dhe drejtuesi ynë i caktoi Zolit si detyrë që të merrej me mua, sepse dukesha premtuese. Dhe kjo pati sukses, sepse pas tre muajve u martuam. Kjo ndodhi para 16 vitesh.

Kujtime të bukura, por sot nuk ndodheni aty.

Edit: Vumë re që kur punonim çdo gjë ishte në rregull, por kur drejtuesi ynë nuk na erdhi në dasëm, kuptuam që nëse nuk prodhojmë me shumë intensitet, atëherë nuk jemi aq të rëndësishëm. U zhgënjem si nga ana shpirtërore dhe nga ajo njerëzore.

Zoltán: Kujtoja se i njihja njerëzit, por pastaj doli që s'ishte kështu. Kurse këtu garancia ishte pikërisht ana njerëzore, personaliteti i Miklos Berkics-it. Ai e meriton të jetë më i miri në botë, sepse personaliteti i tij e përballon këtë, dhe deri më sot është po ai NJERI që ishte në vitin 1999 kur e njoha. Për mua kjo është e rëndësishme.

Pra nuk e mbajtët betimin.

Zoltan: Nuk kishim përse ta mbanim. Dalluam shumë shpejt që ekziston një firmë ku produktet janë të mira, e cila paguan dhe drejtohet mirë. Prandaj thamë ta provojmë, dhe nëse Edit mund të bëjë trefishin e të ardhurave të atëhershme, atëherë nuk do të kthehet të punoj në spital. Pas një viti bënte jo trefishin, por pesëfishin, prandaj nuk kishim më pyetje.

Por zanati yt është një "mision" i vërtetë. Nuk të erdhi keq të hiqje dorë?

Edit: po. Vetëm që ndërkohë u shpëngulëm jashtë qytetit, dhe pashë që çdo mëngjes largohem kur fëmijët janë akoma në gjumë, kurse në darkë kthehem nga puna kur kanë rënë në gjumë. Ngaqë bëja dymbëdhjetë roje në muaj, më mbetej ndoshta vetëm një fundjavë të cilën mund ta kalonim së bashku. Pashë edhe jetën e kolegëve të mi: asnjë martesë ideale për mua, asnjë jetë e qetë familjare.

Zoli, ti nuk bëje roje, por prapë në vitin 2003 hoqe dorë nga puna jote.

Zoltan: Edhe mua më pëlqente, kisha dhjetë vjetë që merresha me rritjen dhe tregëtinë e kafshëve të egra. Vetëm që u lodha, dhe pashë që firma Forever është ajo ku raporti ndërmjet punës dhe të ardhurave është më i miri ndër të gjitha mundësitë e tjera.

Edit thotë që edhe 16 vjet më parë ke qenë tregëtar i suksesshëm, megjithatë nuk dukesh si një starmenaxher. Je modest dhe fjalëpaktë.

Zoltan: SSipas mendimit tim unë kam sukses sepse kam qenë gjithmonë





i besueshëm para miqve dhe të njohurve të mi. Në MLM, ashtu si kudo, kryesorja është personaliteti dhe besueshmëria. Unë nuk kam mashtruar asnjëri, kam bërë biznes korrekt me të gjithë, dhe e mbaj atë që premtoj.

Por thonë që duhet pak jesh edhe pak i sigurt në vetvete.

Zoltan: Ky nuk është stili im. Nuk e bëj atë që ta kërkoj për herë të pestë atë që më refuzoi për herë të parë e të dytë. Të paktën deri tani nuk jam detyruar.

Po Editi? Si tha drejtuesi yt i atëhershëm, edhe sipas teje ka aftësi të mira?

Zoltan: Őszintén? Akkor még egyáltalán nem láttam így. Edit hihetetlen változáson ment át, érdemes lenne összehasonlítani az első előadását a mostanival. Ő ezért nagyon sokat tett, rengeteget olvasott, tanult, naprakész volt mindig a szakmai anyagokból, szóval tudatosan készült. Az áttörést egy 2000-es alkalom jelentette, az Erkel Színházban beszélt. Hihetetlen sokat készült rá, a mai napig elöttem van, annyit izgultunk.

Edit: Më përgëzuan shumë njerëz, laikë dhe mjekë, dhe e përmendën për vite me radhë. Dhe kjo më dha motivimin e duhur.

Nisi biznesi?

Edit: Mund të them që po. Megjithëse atëherë pamë më shumë pjesën e ndihmës. Pamë që produktet kishin efekt dhe donim t'ua jepni menjëherë të

gjithëve. Pastaj bashkë me motrën dhe një kolegen time filluam të ndërtojmë biznes, vetëm sepse e dinim që: ato nuk kishin mundësi tjetër. Motra ime në Zahony rriste vetëm dy fëmijë me pesëdhjetë mijë forinta... kolegia ime ishte infermiere dhe atëherë lindi fëmijën e tretë... jetonin me vështirësi.

Çfarë bëhet me ato sot?

Edit: Janë të dyja menaxhere me të drejtë autori. Për motrën time jam shumë krenare, ishte e para që ndërtoi rrjet të madh në rrethën Szabolcs-Szatmar, ishte e parq që u kualifikua në programin e blerjes së makinës, kanë fituar disa herë çeqe profiti... ndërkohë që në firmë u njoh me burrin e saj, dhe para tre vitesh u martuan në Las Vegas.

Por mendoj se kjo kishte çmimin e vet.

Zoltan: Kishte raste kur kaluam 16 fundjava me radhë në Zahony. Shpeshherë me ne erdhi edhe Miki, madje nga Vjena! Mbanim prezantime në tre drejtime të ndryshme, kurse çdo mbrëmje shkëmbeuim përvojat. Por kjo bënte fjalë akoma rreth ndihmës: kandidatëve fillimisht u afrohemi në aspektin njerëzor, u prezantojmë produktet, dhe nëse u pëlqejnë, prej tyre lindin ndërtuesit e biznesit.

Ndërkohë ka ndryshuar ndonjë gjë në politikën tuaj të biznesit??

Edit: Sot nuk ia ofrojmë të gjithëve mundësinë e regjistrimit. Filluam të përqendrohemi në mardhëniet cilësore, t'u kushtojmë më shumë vëmendje atyre

që mendojmë se kanë vlera. Dhe mësuam gjithashtu t'i dallojmë ata.

Zoltan: Më parë ndodhte shpesh që regjistroheshin njerëz të cilët ishin shumë dinamik dhe flisnin në mënyrë bindëse, por nga ana tjetër nuk ishte i besueshëm para të njohurve të tij. Dhe biznesi nuk mund të ndërtohet me njerëz të cilët nuk kanë sfondin e duhur.

Si ka ndryshuar jeta juaj që nga fillimi?

Edit: Në aspektin e aktivitetit nuk ka ndryshuar shumë sepse kemi jetuar gjithmonë një jetë aktive. Kemi qenë gjithmonë në lëvizje, por për fat të keq jo gjithmonë për mirë. Përditë në punë, pastaj ktheheshim të lodhur në shtëpi, pak gjumë, vazhdimisht në nxitim. Zoli shkante herët në mëngjes tek shoqëria e gjuetarëve, shpeshherë udhëtonte në vend, nuk kishim shumë pushime në jetën tonë.

As puna juaj e tanishme nuk është e lehtë.

Zoltan: : Është e vërtetë që në fillim jetonim një jetë më aktive. Por punonim për vete, dhe kjo na jepte fuqi.

Edit: Në fillim nuk ishte e lehtë që vajzave në darkë nuk u lexoja unë përralla, por ishte gjyshja që i vinte në gjumë. Më kujtohet që Petra njëherë më doli përpara dhe më pyeti që kur do të marrë fund gjithë kjo. Atëherë e kuptuam që duhet t'i përfshijmë edhe ata. U caktuam edhe atyre pikësnyime: po të dalin me deftesë



të shkëlqyer mund të vijë me ne në Amerikë. Kështu kur të voglës donin t'i jepnin nëntë në matematikë, shkoi tek mësuesi dhe u përpoq deri sa arriti ta përmirësonte. Ky u bë motivimi. Parqe lojrash, Disneyland, Grand Canyon... eksperiencia të mëdha për një fëmijë.

Çfarë mund të dimë më shumë rreth tyre?

Edit: Barbara është 15, kurse Petra 13 vjeç, të dyja anë shumë të zgjuara dhe të shëndetshme. Kanë qenë në shkollë gjermane, kurse tani janë gjimnaziste. Barbara doli e para në vitin e saj, kurse Petra del vazhdimisht shkëlqyeshëm.

Cila prej tyre do të bëhet rrjetndërtuesja më e mirë?

Edit: Barbi me karkaterin e saj kolerik është shumë e vetëdijshme, arrin gjithçka që dëshiron. Kurse e vogla të magjeps me karakterin e saj, flet nga mëngjesi deri në darkë dhe ka shumë humor.

Po t'i pyesësh që me çfarë merren prindërit, çfarë përgjigje do të jepnin?

Edit: Sot me siguri jo atë që jep djali i shoqes sime, që nëna e tij është roje. Edhe nëna e tij ishte mjeke dhe djali këtë dëgjonte gjithmonë nga gjyshja që kujdesej për të. Dhe kjo më mbeti në mendje, nuk do doja të rriteshin në këtë mënyrë. Po t'i pyesësh ata tani, Barbara do të thoshte, nëna ime është mjeke, kurse Petra mjeke që ndërton biznes.

Dhe jo ndërtuese biznesi dosido, ashtu si edhe burri juaj. Brenda një viti u bëtë menaxherë, gjë e cila në 99-ën konsiderohej rezultat shumë i mirë. Pas

një viti u bëtë menaxherë me të drejtë autori, dhe çdo vit me një front të ri menaxherësh. Tani jeni soaring. Keni tetë vjet që plotësoni profit sharing, dhe për herë të tretë programin motivues të makinës... ka ndonjë gjë që mund t'ju pengojë?

Zoltan: Tani duhet të punojmë më shumë për të njëjtin rezultat, për këtë bënte fjalë viti i kaluar. Më parë me një rekomandim të mirë produktesh mund të ndërtoje më lehtë biznes, kurse sot propaganda e pjesës së biznesit u bë më e rëndësishme. Por të ndërtoosh biznes, t'i bësh njerëzit të mendojnë për biznes është më e vështirë se sa të rekomandosh produktet.

Edit: Kështu është, fillimisht duhet të luftosh me "kokën" e njerëzve, në mënyrë që të duan të ndërtojnë biznes. Kjo është detyrë më e madhe dhe ndonjëherë s'kemi mjaft kohë dhe energji që të zgjidhim fillimisht problemet e tyre. Prandaj mendojmë që nuk duhet të kooperojmë me çdo kusht me të gjithë.

Ndihmoni të tjerët ër të patur sukses. Për ju çfarë përbën sfidë përveç ndërtimit të biznesit?

Zoltan: Përshebull të shpëtojmë një mace të vogël. E them seriozisht, sepse duket diçka e vogël, por s'ka sukses më të madh se sa kur i rikthen jetën një kafshë të vogël. I duam shumë kafshët, përshebull nëse shikojmë një mace të

vetmuar në rrugë, nuk jemi në gjendje ta lemë aty. Kemi rritur shumë kafshë!

Edit: po, këto janë gëzime të vogla në jetë. Por ka edhe gëzime më të dukshme për botën: në vitin 2008 realizova një nga ëndrrat e mia të vjetra: hapëm një qendër bukurie dhe shëndeti. Salloni Fónix është një vendi rikrijimi, ku me dobësim dhe trajtim trupi i ndihmojmë të gjithë të arrijnë maksimumin. Motoja ime është „Ti je më i miri”, sepse jam e bindur që besimi në vetvete është çelësi i gjithçkaje.

Të bën të lumtur paraja?

Edit: Jo, vetëm niveli i jetesës që mund të sigurohet vetëm nëpërmjet saj. Përparësia kryesore e këtij biznesi është: herë pas here i lejon njerëzit të shplohden

Ndonjëherë ka shumë nevojë për shplohje. Edhe ju keni patur periudha të vështira familjare.

Zoltan: Kur babai im vdiq në 2006-ën, Edit më çliroi nga shumë gjëra. Natyrisht edhe unë bëra gjithçka që duhej bërë, vetëm që nuk e kisha aty mendjen. Kurse në 2004-ën Edit nuk punonte dot për shkak të problemeve shëndetësore. Në këtë periudhë e la pas dore ndërtimin e biznesit, por MLM edhe në këtë rast e tregoi madhësinë e saj. Por pavarësisht se u tërhoqëm pak, nuk na ndryshuan të ardhurat. Ajo që kishim ndërtuar deri atëherë funksiononte vetë.





PROGRAMI NË INTERNET

21.10 – 28.10.2010

- 18:00, 06:00** Rex Maughan
Reportere: Paczoly Klaudia
- 18:20, 06:20** Forever-film
Forcë e trefishtë
- 18:55, 06:55** Dr. Kósa L. Adolf
Ndërtim skuadre në nivel të lartë
- 19:25, 09:25** Dr. Kassai Gabriella
Ruajtje shëndeti në dimër
- 19:55, 09:55** Dr. Bakanek György
Parandalim me aloe vera
- 20:15, 08:15** Tonk Emil
Biznesi është vlerë
– Si t'i përfaqësojmë vlerat?
- 20:55, 08:55** Utasi István
Përcaktim qëllimesh
- 21:25, 09:25** John Curtis: Edhe ti mund të
shkëlqesh si Diamant!
- 22:20, 10:20** Dr. Samu Terézia: Mënyrë jetese e
shëndetshme në FLP
- 22:50, 10:50** Szilágyi Zoltánné
Moshë s'ka rëndësi
- 23:20, 11:20** Minutat e Sonya-s pjesa 1
Masazh me mjaltë
Minutat e Sonya-s pjesa 2
Higjenë
- 23:25, 11:25** Berkics Miklós
- 23:55, 11:55** Dr. Bagoly Ibolya
Më thuaj, çfarë kërkon nga jeta?
- 00:35, 12:35** Rex Maughan
- 01:25, 13:25** Aidan O'Hare
- 02:20, 14:20** Minutat e Sonya-s pjesa 3
Higjenë dhe trajtim flokësh
- 02:25, 14:25** Senk Hajnalka
Po qan apo po qesh
- 03:00, 15:00** Hertelendy Klára
Parimet bazë të sponsorizimit
- 03:20, 15:20** Siklósné dr. Révész Edit
Antioksidantët natyror
në parandalim dhe mjekim
- 04:00, 16:00** Minutat e Sonya-s pjesa 4
Trajtim lëkure
- 04:05, 16:05** Dr. Samu Terézia
Guxo të ëndërrosh!
- 04:55, 16:55** Senk Hajnalka
Një biznes i ndërtuar me mjeshhtëri
- 05:25, 17:25** Dr. Seresné dr. Pirkhoffer Katalin
dhe dr. Seres Endre
U bëmë safirë!

23.09 – 21.10.2010

28.10 – 04.11.2010

- 18:00, 06:00** Aidan O'Hare
Reporter: Dr. Kósa L. Adolf
- 18:20, 06:20** Forever film, Forcë e trefishtë
- 18:55, 06:55** Marija Buruš: Përdorimi
i përditshëm i produkteve FLP
- 19:30, 07:30** Lipp Szilvia dhe Molnár Mihály
U bëmë sundimtarë, pra jemi në
rrugën e suksesit
- 19:55, 09:55** Dr. Steiner Renáta: Jeta jote, vendimi yt
- 20:15, 08:15** Minutat e Sonya-s pjesa 5, Sonya Skin
Care, Minutat e Sonya-s pjesa 6,
Fleur de Jouvence
- 20:25, 08:25** Zsiga Márta
Bota e mrekullueshme e Forever-it
- 20:50, 08:50** Dr. Milez Sándor: Roli i individit
në marketingun direkt
- 21:25, 09:25** Minutat e Sonya-s pjesa 7, Scrub
Minutat e Sonya-s pjesa 8,
Marine Mask
- 21:30, 09:30** Berkics Miklós: Në krye të Europës
- 21:50, 09:50** Michael Strachowitz: Bazat e suksesit:
qëndrimi, motivimi, teknika
- 22:45, 10:45** Dr. Gothárd Csaba: Komunikimi është
mjete i krijimit të marrëdhënieve
- 23:20, 11:20** Dr. Kiss Ferenc dhe dr. Nagy Ida
Hapi i parë me të vërtetë i madh –
U bëmë Senior
- 23:45, 11:45** Dr. Kósa L. Adolf: Ëndrrat dhe
pikësynimet e mia të realizuara
- 00:10, 12:10** Rex Maughan. Leksion me titra
- 00:45, 12:45** Minutat e Sonya-s pjesa 11: Sonya
Colour Collection, Minutat e Sonya-s
pjesa 12: Bazë, Minutat e Sonya-s
pjesa 13: Paletë ngjyrash
- 00:55, 12:55** Yjet e FLP-s I.
- 01:45, 13:45** Yjet e FLP-s III.
- 02:45, 14:45** Tóth Sándor dhe Vanya Edina
Ëndërro, planifiko, shijo!
- 03:15, 15:15** Nógrádi Bence
- 03:55, 15:55** Minutat e Sonya-s pjesa 14:
Metoda makijazhi, Minutat e
Sonya-s pjesa 15: R3 Factor
- 04:00, 16:00** Tre Graciet bisedojnë
- 04:20, 16:20** Berkics Miklós: 13 vjet sukses
- 04:55, 16:55** Pere Hilda: Histori sukses
- 05:20, 17:20** Hertelendy Klára: Gjithmonë e më lart!
- 05:55, 17:55** Minutat e Sonya-s pjesa 3
Higjenë dhe trajtim flokësh

11.04 - 11.13.

- 18:00, 06:00** Forever film
Forcë e trefishtë
- 18:40, 06:40** Dr. Milez Sándor
Reporter: dr. Kósa L. Adolf
- 18:55, 06:55** Yjet e FLP-s
Raundi i dytë, pjesa 1
- 19:50, 07:50** Lenkey Péter
Reporter: dr. Kósa L. Adolf
- 20:00, 08:00** Vágási Aranka dhe Kovács András
Cogito Ergo FLP
- 20:25, 08:25** Szabó József
Erdha në shtëpi
- 20:50, 08:50** Siklósné dr. Révész Edit
Raport
- 21:10, 09:10** Mbresa nga World Rally
- 21:50, 09:50** Vágási Aranka dhe Kovács Botond
- 22:35, 10:35** Siklósné dr. Révész Edit
Raport 2.
- 22:50, 10:50** Yjet e FLP-s
Raundi i dytë, pjesa 2
- 23:35, 11:35** Aidan O'Hare
FLP Europa
- 00:35, 12:35** Halmi István
Raport
- 00:50, 12:50** Nagy János dhe
Nagyné Postás Judit
NDP
- 01:00, 13:00** Halmi István
Zgjero!
- 01:55, 13:55** Gulyás Melinda
Guxim për jetën
- 02:15, 14:15** Tonk Emil
Merre seriozisht!
- 02:55, 14:55** Hajcsik Tünde
Raport
- 03:10, 15:10** Grupi muzikor Android
& konkursi Miss Sonya
Miss Sonya
- 04:10, 16:10** Bánhidy András
Ndërtoj biznes dhe familje
- 04:30, 16:30** Dr. Bakanek György
Produktet gjallëruese të Forever-it
- 04:50, 16:50** Dr. Gothárd Csaba
Unë mësoj, ti mëson,
ne zhvillohemi
- 05:10, 17:10** Hajcsik Tünde
Krishtlindjet e Forever-it
- 05:35, 17:35** Berkics Miklós
Ju jeni më të mirë!

13.11 – 18.11
DITË SUKSESI NON-STOP

www.foreverliving.com



E dashur Shqiponjë e Re!

Të përshëndes me dashamirësi në botën e larmishme të Forever Living Products. Shpresoj ta kesh kuptuar që tek ne nuk mërzhitesh. Forever është një vend me të vërtetë i mrekullueshëm, arena e emocioneve dhe ishulli i qetësisë njëkohësisht.

Nga njëra anë është një firmë botërore që ka një pamje të ardhmeje të sigurt dhe të vendosur dhe një politikë stabile biznesi që prej tridhjetë e tre vitesh në pothuajse 150 vende të botës, ku është gjithmonë mirë të kthehesh, një vend ku takohesh me miq, ku bën biseda dhe blerje të mira. Nga ana tjetër një Forever dinamike plot gjallëri ku krijohet e ardhmja dhe ndodhin gjërat me të vërtetë të rëndësishme të jetës tënde.

Tek ne viti është njëlloj si pesë vjet në vende të tjera – përsa i përket përvojave, mbresave, shikimit të botës, zhvillimit të personalitetit, përparimit, vlerësimit dhe të ardhurave.

S'është e lehtë të përmendësh as gjithë gjërat që ndodhën gjatë gjashtë-tetë muajve të fundit!

U zhvilluan trainime të ndryshme në çdo vend, si dhe World Rally në Brazil. Qindra anëtarë të Forever-it përfaqësuan rajonin tonë në aktivitetin më të madh të Europës, në takimin Rally European dhe Ndarja e Profitit në Londër. Ditë

Suksesi me dhjetra mijëra pjesëmarrës brenda dhe jashtë vendit. Në

Beograd Ditë Suksesi ndërkombëtare në shoqërinë e Aidan O'Hare.

Në Budapest erdhi krijuesi dhe drejtuesi i përgjithshëm i Forever-it Rex Maughan dhe drejtuesi i Europës Aidan O'Hare. Para kësaj takim njëditor ndërkombëtar menaxherësh në kështjellën magjepsë të Szirakit.

Në shtator Ditë Suksesi në Mal të Zi në zonën bregdetare me pesë yje Splanded, ku ka qenë njëherë edhe James Bond (si vendi i xhirimit të Casino Royal) – dhe ku ne do të jemi shpeshherë. Mr. Bond shkoi për punë, kurse ne shkuaam për t'u shplobhur, për të mësuar dhe për t'u argëtuar.

Në muajt e pranverës qindra anëtarë fillestar të Forever-it filluan të plotësonin kushtet e nivelit të parë dhe të dytë të kualifikimit për në Holiday Rallyn e Poreçit – kurse kualifikimin e tetorit e arritën edhe më shumë sa kaq. Dy pushime verore, trainime dhe argëtime fantastike brenda tre muajve, dhe kjo s'është gjithçka: deri më 31 tetor zgjat periudha e kualifikimit për në Rallyn European të vitit 2011 në Vjenë. Si je me pikët? Ke akoma edhe disa ditë, shfrytëzoji ato.

Në Budapest me aktivitetin kombëtar dy ditor Dita e Shëndetit Forever krijuam një traditë të re dhe u bëmë histori. Jemi firma e parë MLM e cila e nxorri "në rrugë" mes njerëzve realitetin e Forever-it, bëmë të mundur për dhjetra mijëra njerëz të rinj që të na njohin dhe të na duan.

Edhe një lajm tjetër i mirë! Nga data 1 nëntor çdo anëtar i Forever-it që ndodhet në nivelin e distributorit dhe nuk ka bërë blerje në emrin e tij gjatë gjashtë muajve të fundit, mund të regjistrohet përsëri në mënyrë të lirë pa procedurën e risponsorizimit.

Të thashë që nuk do të mërzhitesh!

Tibor Radoczki

DREJTOR RAJONAL
SOARING MENAXHER



SHESH

*„Kudo është mirë, por më mirë është në Ditën e Shëndetit.”
– tha djali im Benjamin pasi mbledhi të gjitha dhuratat e
mundshme për përgjigjet e tij të dubura.*

për lirinë



Shpërthim. Për ditë të tëra këtë fjalë kam në mendje. Këtë ndjeva edhe në Ditën e Shëndetit. Kjo është fjala me të cilën mund të karakterizohet më mirë se çfarë po ndodh në rajonin e Hungarisë të Forever-it.

Kur mbërrita bashkë me gruan time Brigitta dhe dy fëmijët e mi, Benjamini shtatë vjeç dhe Szonja pesë vjeç, në sheshin e Lirisë u mbusha me një krenari të papërshkrueshme: „E përjetuam edhe këtë!” – dhe falenderova. Edhe emri i vendit „sheshi i Lirisë” për mua përmban një domethënie simbolike. Pasi edhe unë prandaj e fillova. Pashë garanci për lirinë time personale para shtatë vitesh në filozofinë e jetës së Forever-it dhe në njeriun të cilin që atëherë e njoh mirë personalisht, dhe nga i cili u nis e gjitha: Rax Maughan.

Kur me familjen time të vogël po nxitonim drejt sheshit, ndjemë që kjo ditë do të ketë rëndësi historike në jetën e Forever-it. Madje edhe në jetën e firmave MLM. Asnjëri nuk ka qenë i aftë të mbledh një turmë të tillë në këtë treg dhe të organizoj një aktivitet të hapur kaq të madh si tani Foreveri. Dr. Sandor Milesz, vizioni i të cilit shkon shumëherë më larg nga ç’ e mendojnë disa njerëz, sot me skuadrën e tij treguan përsëri se çfarë është profesionizmi. Kur bëhet fjalë për ditë shëndeti atëherë le të shkruhet me shkronja të mëdha, Ditë Shëndeti! Të vemë në lëvizje të gjitha forcat që sot dëshirojnë të arrijnë shëndetin sipas përkufizimit të WHO. *„Shëndeti është gjendja e mirëqenies së plotë fizike, mentale-shpirtërore dhe sociale, dhe jo vetëm mungesa e sëmundjeve apo dobësimi.”* Le të bëj fjalë rreth kësaj Dita e Shëndetit Forever!

NGA NISI KJO?

Në intervistën e përgatitur me të, e cila mund të shikohet edhe sot në Youtube nëse dikush kërkon me fjalët „forever” dhe „dita e shëndetit”, Sandor thotë që dëshironte të bëhej distributor jo vetëm në ambient me dyer të mbyllura, por duke marrë përsipër misionin tonë të prezantohemi edhe hapur drejt botës, Hungarisë.





Forca e tij organizuese, qetësia, gjakfohtësia dhe natyrisht lidhjet e tij njerëzore bënë të mundur që të marrim një vend të tillë strategjik për këtë.

Kjo është çështja më fisnike sot. Përmirësim i cilësisë së jetesës. Ekzaminime falas. Programe fëmijësh. Informacione rreth temës së ruajtjes së shëndetit dhe krijimit të sigurisë materiale. Ushqime dhe pije të shijshme. Provim kosi. Dhe një sërë gjërash të tjera që prisnin vizitorët këtu.

Pastaj personazhet e këtij organizimi. Nga Shoqata e Mjekëve Popullor Hungarez morrëm një mbështetje profesionale me ndihmën e të cilës gjatë dy ditëve patëm mundësinë të shfaqim mjekët, lektorë të mjekësisë popullore dhe profesorët më të mirë të universitetit. Artistë të cilët japin me pasion shfaqje në këtë atmosferë fantastike, dhe natyrisht duke zotëruar përvoja me produktet Forever flasin gjuhë të përbashkët me shumicën e njerëzve që i shikojnë. Tregëtarë të cilët gjatë viteve të kaluara siguruan jo vetëm shëndetin por edhe gjendjen e tyre materiale, të cilët me marrdheniet e tyre njerëzore, ashtu si Sandor, u japin shembull njerëzve që jetojnë në mjedisin rreth tyre. Firma multinacionale të cilët sot janë partnerë në faktin që e mbështesin FLP-n si sponsor në ndonjë çështje të mirë. Kur mbërrim në shesh na pret vend organizimi i rregullt, çadra të bardha, skenë e madhe qendrore, si dhe një trumë që bisedon e gëzuar me njëri tjetrin. Duke shëtitur ndërmjet çadrave na dalin përpara fytyra të njohura dhe megjithëse koha duket e trishtuar, fytyrat tona janë të qeshura. Nuk duhet të na vij turp për asgjë, kemi mbërritur në një stacion të rëndësishëm të profesionit tonë rrjetndërtues.

Duke shëtitur para një çadre të bardhë, shikoj të mbidhet një turmë e madhe të cilët shikojnë drejt çadrës. Janë më shumë njerëz jashtë se sa brenda. Me sa duket dikush nën tendën e bardhë po thotë diçka me vler. Përballë hyrjes së çadrës në sheshin e lojrave vrapojnë fëmijët. Kjo është çadra e Forever-it me leksione biznesi. Me sa duket shumë njerëz janë kureshtar për leksionin që po jepet brenda” – them me vete. S’ka problem, vitin tjetër do të ngremë një çadër më të madhe për lektorët.

Dita kalon me biseda të ndryshme. Ndërkohë shikojmë skenën e madhe dhe shfaqjet e shkëlqyera. Fëmijët s’i kam më problem. Kaluan në një botë tjetër, luajnë me të kapura në rërë dhe ndërtojnë kështjella me bidonat plastik të xhelit aloe. Janë të sigurt, për ta kujdesen animatorët.

Ndërkohë edhe unë marr sms-t. „Shiko, as sot nuk mund të vijmë dot, sepse për shkak të kohës së keqe kemi frikë të nise mi.” Pastaj vjen tjetri: „Këtu jemi, ku ju gjejmë?”

Njëri e refuzon, tjetri vjen. Njëlloj si në ndërtimin e rrjetit. Natyrisht tani edhe unë ftova vetëm ata që e simpatizojnë firmën dhe shëndetin, por s’kanë qenë akoma në ndonjë aktivitet zyrtar FLP-je.

Marrim në telefon sponsorin tim Rex Alex, sepse edhe Ai dëshiron të dij se ku ndodhemi. Gjithë menaxherët e mi ndodhen këtu. Balázs, Sagi, Kriszta, Ágika, Rita dhe Gabó, Pati... I falenderoj, shkëmbej dy-tre fjalë me ta dhe përpiqem t’i fus mes kandidatëve civil, që pastaj javën që vjen të takohemi në prezantimin e hapur ku u bëjmë të njohur konkretisht sekretet e ndërtimit të rrjetit. Përballë na vjen Miki Berkics: - Adam, përgëzime për promocionin në internet! Intervistën e doktoreshës Revesz brenda një dite e panë më shumë e pesëqind njerëz! I tregoj Mikit që kjo nuk ishte idea ime, por e Tibi Lapidz-it, dhe ky përjashtim nuk do të ishte bërë dot pa miratimin e Zsolt Fekete-s dhe Klubit të Presidentëve. Por jamë me të vërtetë krenar për veten time që me një nismë amatore e përhapëm shumë shpejt lajmin rreth kësaj në internet disa ditë para aktivitetit të madh.

Brigi mbledh fëmijët. Të djersitur përpiqen me fjalinë e zakonshme „qëndrojmë edhe 5 minuta”, por nëna e tyre është e vendosur. Edhe nesër do të jetë një ditë e madhe, vazhdon shpërthimi. Presim dhjetra mijëra njerëz. Erdhi koha të shplohemi. Mbushemi me kënaqësi dhe gëzim. Nuk u turpëruam. Misioni u plotësua, dhe shkojmë mëtej në rrugën e shëndetit, sigurisë material dhe lirisë personale.

**Adam Nagy
Senior Menaxher**



MË SHUMË SE NJËZET ÇADRA, VIZITA TË PLOTA SHËNDETËSORE, LEKSIONE NË TRE VENDE TË NDRYSHME, SHOW SPEKTAKOLAR NË SKENËN E MADHE: FLP HUNGARIA PAS 13 VITESH I TREGOI VETEN BOTËS SË GJERË KUR ORGANIZOI DITËN E PARË TË SHËNDETIT TË ORGANIZUAR NË SHESHIN E LIRISË SË BUDAPESTIT. REAGIMET ISHIN TË QARTA: ISHTE ME VLERË!



NJË FUNDJAVË NË FOTO
Hapje drejt botës



„Qëndrova në radhë kudo, më ekzaminuan gjithçka që nga pesha deri tek zemra. Dhe rezultatet dolën mirë pavarësisht nga fakti që nivelin e shaqerit e kam të lartë. E njoh firmën prej dhjetë vitesh, por tani e nisa seriozisht ndërtimin e biznesit. Një Ditë Shëndeti e tillë është shumë e mirë për t'u bërë të njohur njerëzve mundësitë që përmban kjo botë.”

Katzer Katalin

„Sjellin vazhdimisht bidonat e aloe-s, janë prej rëre, rrëshqasin, në vend të piramidës do të bëhet mur kalaje. E rëndësishme është që loja u pëlqen fëmijëve. Kushti i dhuratës është radhitja e produkteve. U ecën shumë mirë, ka nga ato që as unë nuk i njoh...”

Mátyás Ágnes

“Sot kishte shumë leksione të shkëlqyera. Dëgjova Kósa L. Adolf, Klaj Ágnes... Më pëlqen shumë lufta me të cilën përpiqen të shumëfishojnë një „shembull njeriu” në radhë gjithmonë e më të gjera. Në mënyrë që të mos jemi pozitiv vetëm në teori, por edhe në ditët e zakonshme.”

Kállai Imre

“Në tezgën tonë është shkruar që gjenden bileta për në Ditën e Suksesit. Shumë njerëz pyesin që çfarë është kjo? Por kur themi aloe vera, të gjithë na identifikojnë.”

Lengyel Bea

“Është i madh interesimi, shumë njerëz erdhën tek ne gjatë gjithë ditës. Shumë prej tyre ishin anëtarë të Forever-it të cilët i përdorin produktet. Ata kanë më shumë informacione rreth shëndetit se sa njerëzit e zakonshëm, dhe sipas përvojës sonë edhe gjendja e tyre shëndetësore është më e mirë. Dhe ne natyrisht përpiqemi t'i edukojmë të gjithë për një mënyrë të shëndetshme jetese.”

Heréd Rozália, mjeke

„Fëmijët vijnë vazhdimisht që në mëngjes. Nga shishet me ujë mineral Sirona u përgatitëm shkollë, nga bidonat e xhelit aloe fushë me pengesa, por gjendet edhe rrotullame fati dhe fushë boulingu. Shumë vetë vijnë me bluzë Foreveri, por ata që jo, mund ta fitojnë atë tek ne.”

Nagy Móni

“Për fat të mirë nuk kishim asnjë rast gjatë gjithë ditës, falë Zotit gjithçka është e qetë. Pranim dëmtime të vogla dhe gjëra të ngjashme, por nuk ndodhi asgjë. Nuk jemi rastësisht në Ditën e Shëndetit!”

**mjek urgjence,
Shërbimi Fónix**





"I bëmë nja dy vizita: më panë indeksin e peshës së trupit dhe kapacitetin e mushkrisë, dhe gjithçka ishte në rregull. Erdha bashkë me djalin e vogël, kurse burri im erdhi më vonë. Jemi anëtarë të rrjetit

Vörös Anikó, Budapest



"Ndodh që na kërkojnë kafe, cigare dhe kola, por rrallë. Shumë njerëz shikojnë ushqimet e shëndetshme, por çmimi është gjithmonë aspekti kryesor. Megjithatë çdo qindarkë e shpenzuar për mënyrën e shëndetshme të jetesës shpërblehet."

Shitëse, dyqani i shëndetit

"U preka pak... kam dhënë leksione si veteriner, por jo në sheshin e Lirisë! Kjo është pak ndryshe. Interesante është që njerëzit sakrifikojnë më shumë për kafshët se sa për veten e tyre. S'ka problem, edhe kjo po zhvillohet, dhe është një degë e re në ndërtimin e biznesit. Duhet të ha pak çokolatë kundër ankthit. Por vetëm sepse s'kam me vete Fast Break..."

Dr. Újhelyi János



"Gëzohem, është mirë të hapesh ndaj njerëzve, edhe nëse ata nuk e presin gjithmonë mirë. Por leksionet e japin efektin e duhur. Ky i tanishmi përshembull ishte shumë interesant: bënte fjalë rreth faktit që bëhesh njëlloj si ushqimi që ha. Ky është një rregull bazë, unë e besoj dhe do ta përcjell mëtej."

Varga Zsuzsa



"Natyrisht që qëndrojmë deri në fund në radhë! Jam kureshtarë për gjendjen time shëndetësore, dhe këtu brenda një dite mund të marr vesh gjithçka, për të cilat në ambulanca duhet të pres me muaj të tërë. Këtu t'i japin menjëherë rezultatet, prandaj i përgëzoj organizuesit!"

Mészárosné Horváth Gabriella, Budapest

- What is this?
- The Forever's Health Day.
- Forever?
- Aloe vera ...
- Á, aloe vera, ok, good! Forever young!

Martin, Paris





“Idea është që njeriu të mos mbaj leksion për vetveten. Leksioni të jetë interaktiv, të kesh mundësi të pyesësh: këtu fillon bashkëpunimi. Natyrisht përveç rritjes së sasisë i duhet kushtuar vëmendje edhe cilësisë. Një aktivitet i hapur është përgjegjësi e madhe: nevojitet më shumë koordinim dhe një organizim më i saktë se sa në një program të mbyllur. Pavarësisht nga kjo unë tregova vetveten, u drejtohem njerëzve kudo njëjloj.”

Krizsó Ágnes



„Sallami i dërrit kishte sukses të madh. Duhet ngrënë ushqim me kalori, dhe këto lëndë bazë janë të shëndetshme. Nëse njeriu është në gjendje të mirë, atëherë mund të konsumoj pa problem gjëra të tilla!”

punonjës nga restoranti



“Duhet të kuptojmë jo vetëm anëtarët e FLP-s, por edhe laikët. Atyre natyrisht është më e vështirë t’u shpjegosh që përse duhen plotësuar vitaminat, dhe përse pikërisht me produktet që unë përdor prej 13 vitesh si mjeke. Tek kjo kam për ta vendosur theksin në leksionin tim. Për mua tani më e rëndësishmja është që u hapëm drejt botës. E rëndësishme është që çdo njeri ta kuptoj që ka nevojë për mënyrën e jetesës dhe të menduarit që përfaqësojmë ne.”

Dr. Bagoly Ibolya

“Një aktivitet i tillë është shpëlodhje, kurse për ne ngarkesë profesionale. Është e rëndësishme të ndërtojmë marrëdhënie reciproke partneri me organizata që përfaqësojnë vlera të njëjta, prandaj jemi këtu. Njerëzve u intereson gjithçka në lidhje me mënyrën e natyrshme të jetesës dhe njohjen e vetvetes, në çadrën tonë dëgjojnë leksione me tema të tilla. Behet fjalë rreth jogës, numerologjisë... shumë njerëz janë të stresuar, të ngopur me mënyrën e jetesës në qytet, kurse ky këtu, në sheshin e Lirisë, është ishulli i paqes.”

Pál Erzsébet, Shoqata e Mjekëve Popullor Hungarez

“Shumica interesohen për analizat dhe pyesin për informacione bazë rreth firmës. Ka nga ata që nuk kanë dëgjuar ndonjëherë rreth saj... Jo të gjithë erdhën me informacione korrekte, këto i korrigjojmë, por qëndrimi i tyre më duket plotësisht pozitiv, ata që erdhën këtu ishin kurrështarë. Dhe qëllimi është që ata që punojnë këtu, të përcjellin emrin pozitiv të profesionit.”

Gyimesi Orsolya

“Po bisedonim me një grua irlandeze, i pëlqeu aktiviteti, nuk di hungarisht, por atmosfera dhe njerëzit patën efekt. Nuk detyrojmë asnjëri, ai që dëshiron i dëgjon leksionet, ai që jo shkon mëtej. Unë e ndërtoj biznesin prej një viti, nuk është akoma siç duhet, por po punoj që të shkoj më mirë.”

Kristyán Róbert



Holiday Rally

TË KUALIFIKUARIT QERSHOR-GUSHT 2010

NIVELI II.

BADURINA EDVARD & MIČIĆ TEA • BUSI GÁBORNÉ & BUSI GÁBOR • CSONTOS SÁNDORNÉ • DOBOS KRISZTINA • DR. KOCSIS ILONA & DR. SAS VILMOS • DR. SZÉNAI LÁSZLÓ & DR. SZÉNAINÉ KOVÁCS GABRIELLA • DRENJAKOVIĆ RADMILA • KIRÁLY BARBARA & KIRÁLY ADRIÁN • KOVÁCS MIHÁLYNÉ & KOVÁCS MIHÁLY • KRAGOLNIK INNA • SEBESTYÉN TIBOR DÁVID • SZABÓ ATTILA • TUBOLY IMRE • VIRÁNYI SZILVIA & SZABÓ ZOLTÁN • VRLIĆ IVAN • VUJIĆIĆ VIOLETA & VUJIĆIĆ MILAN • KATONA ÁGNES & POLGÁR ANTAL

NIVELI I.

BANIC NEDJELJKO & BANIC ANICA • BARA IMRÉNÉ & BARA IMRE • BARANYÓNÉ TAR TERÉZIA • BARÁTH ANETT • BARTUS BRIGITTA • BARTUS NIKOLETT • BERÉNYI FERENCNÉ • BOGNÁR KATALIN & BOGNÁR LÁSZLÓ • BRUMEC KARINA & BABIĆ GOZARD • BURÁK ATTILA & BURÁK-KOVÁCS KRISZTINA • CSOBÁN MIHÁLY & CSOBÁNNÉ STELKOVICS EDIT • DAVIS ERIKA & DAVIS HENRY • DECKER VIVIEN • DJUKIĆ GORDANA & DJUKIĆ ZORAN • DOROGINÉ BALLA GYÖRGYI & DOROGI ZOLTÁN • DR. GOMBKÖTŐ GYULÁNÉ • DR. MEDGYESINÉ DR. GESZTESI STEFÁNIA & DR. MEDGYESI JÁNOS ANDRÁS • DROPULIĆ LORENA & DROPULIĆ MARIO • ESZTERGÁLYOS MÁRTA • FEJSZÉS FERENC & PERÉNYI MÓNICA • GOLDSCHMIDT-NAGY GABRIELLA & GOLDSCHMIDT NORBERT • GULYÁSNÉ CZAKÓ TÜNDE & GULYÁS ISTVÁN • GYIMESI ORSOLYA & GYIMESI LÁSZLÓ • HALASI NORBERT & ÁCS RENÁTA • HEGYES KATALIN • HORVÁT VERONA & HORVÁT ANTUN • IVANICS JÁNOSNÉ & IVANICS JÁNOS • JOÓ JULIANNA & KÁVÁSI MIHÁLY • JUHÁSZ ATTILA & GÁL BEÁTA • JURIŠIĆ ZORKA • KATONA GYÖRGY • KIRÁLY ATTILA & KIRÁLYNÉ TÍMÁR LILLA • KISS ATTILA • KOLESZÁR TAMÁS • KÓNYÁNÉ MIKLÓS ERZSÉBET • KOVÁCSNÉ DR. NAGY RÉKA & KOVÁCS ZOLTÁN • KURUCZ ISTVÁN & DÉKÁNY MÓNICA • LÁSZKÁNÉ CZAKÓ ANITA & LÁSZKA PÉTER • LUKIĆ DANIJELA & LUKIĆ DJORDJE • MACZÓ ROZÁLIA & KOCSIS PÁL • MARKOVIĆ ANICA & MARKOVIĆ ALEKSANDAR • MÉSZÁROSNÉ MARKUS MÁRIA • MILISAVLJEVIĆ TAMARA & MILISAVLJEVIĆ VUK • MILOSAVLJEVIĆ PREDRAG & MILOSAVLJEVIĆ MILANKA • MOLDVAY ILDIKÓ • NAGY GÁBOR & NAGY GÁBORNÉ • NETYÉNÉ SZILÁGYI ILDIKÓ & NETYE ZSOLT • POPOVIĆ RADAN & POPOVIĆ SONJA • PRAZIĆ SMILJA & PRAZIĆ MILAN • PRIBICEVIĆ JOVICA & PRIBICEVIĆ JEKLA • RÁ CZ VIKTÓRIA • RADIVOJEVIĆ TRNAVAC MARIJA & RADIVOJEVIĆ SAŠA • RÁDY ANTALNÉ & RÁDY ANTAL • RAFFAY LÁSZLÓ ISTVÁNNÉ • SAVELJIĆ DJORDJE & SAVELJIĆ VERA • SZABÓNÉ BRUDER ERIKA • SZENTE GÁBORNÉ • SZÍJJ DOROTTYA • TORNyai GYULÁNÉ & TORNyai GYULA • TÓTH TAMÁS & BOSTYAI EMÍLIA • TÖRÖK MÓNICA & VÍGH FERENC • VÁMOS KATALIN • VASILJEVIĆ LAZAR & GLUMIĆIĆ MILICA • VUKČEVIĆ MILENA • ZOKIĆ IGOR & ZOKIĆ GALJA • MARKOVICS GYÖRGY & STÉFELY ÉVA • SIMON ZSUZSANNA & BÉNI ROLAND • TRIPSI GÁLCZNÉ TANOSS KATALIN & TRIPSI GÁLCZ DIMITROV • PAVLIKNÉ MOLNÁR PIROSKA & PAVLIK LÁSZLÓ

FOREVER 
IMRPRESSUM

Botues: Forever Living Products Hungari Shpk. **Redaksia:** FLP Hungari Shpk. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Kryeredaktor: Dr. Sandor Milez Redaktor: Valeria Kismarton, Zsuzsanna Petroczy, Kalman Posa, Sandor Rokas,

Layout, përgatitje për shtypje: Crossroad Consulting Shpk. **Koordinator projekti:** Szilvia Timar Redaktor leximi: Zita Kempf Korrigjues: Ildiko Kiraly **Redaktor projekti:** Raden Hannawati **Fotograf:** Robert Laszlo Bacsi **Përkthim, redaktim:** Dr. Marsel Nallbani (shqip), Babity Gorán Vladimír, Žarko Anić Antić (kroat), Ottilia Toth-Kasa, Balazs Molnar, Dragana Meseldžija (serb), Jolanda Novak Csaszar, Biro 2000 Ljubljana (sloven). **Shtypshkronja:** Palatia Nyomda és Kiadó Shpk. U përgatit në 30500 kopje.

Për përmbytjen e artikujve përgjegjësia është e autorëve. Çdo e drejtë mbrohet!

www.foreverliving.com



ARGI+™ L-Arginine & Vitamin Complex

L-arginina është një aminoacid shumë i efektshëm të cilin shkencëtarët e quajnë „molekula mrekullibërëse”. E quajnë kështu me shkak, sepse kontribuon në ruajtjen e qarkullimit të shëndetshëm të gjakut, kurse qarkullimi i mirë i gjakut përforcon shëndetin e pjesëve të ndryshme të trupit.

Argi+™ përveç L-arginin me vlerë përmban edhe:

- Shegë, e cila është e njohur për efektin e saj antioksidant
- Ekstrakt vere të kuqe, i cila ndihmon për ruajtjen e nivelit të shëndetshëm të kolesterolit
- Ekstrakt frutash dhe lëkure rrushi, i cili forcon zemrën dhe enët e gjakut, si dhe sistemin imunitar
- Shumë vitamina me vlerë të cilat janë të domosdoshme për ruajtjen e shëndetit.

Përbërja e saj është krijuar në mënyrë të tillë që konsumimi i një doze siguron për të rriturit sasinë e rekomanduar ditore të vitaminave C, D3, K2 B6, B12 dhe acidit folik. Me këtë kombinim të lëndëve vepruese u krijua një plotësues ushqimor i ri me të cilin ju mund ta mbështesni thjeshtë gjendjen shëndetësore të organizmit tuaj.

Përzieni një dozë Argi+™ në një gotë me ujë Si-rona ose me pijen aloe të preferuar, duke ndihmuar me këtë rritjen e rendimentit të organizmit tuaj, si dhe siguron sasinë optimale të L-argininës për ushqimin e shëndetshëm të familjes suaj.

MËNYRA E PËRDORIMIT:

Përzieni një dozë pluhuri Argi+™ në 2,5 dl ujë ose pije tjetër njëherë në ditë. Mos e kaloni sasinë e rekomanduar! Plotësuesi ushqimor nuk e zëvendëson ushqimin e larmishëm dhe të ekuilibruar.

PËRBËRËS TË TJERË:

Acid citrik, aromë natyrore frutash të ndryshme, xillit, D-riboz dhe sukraloz.

Konsumimin e produktit diskutoje me mjekun nëse jeni shtatzanë, jepni gji ose merrni trajtim për ndonjë sëmundje.

	1 dozë (10 g)	RDA%*
Energji	40 kcal (167KJ)	
Proteina	0 g	
Karbohidrate	3 g	
Nga këto sheqer	3 g	
Yndyra	0 g	
Vitamin C	80 mg	100%
Vitamin D3	5 µg	100%
Vitamin K2	75 µg	100%
Vitamin B6	1,4 mg	100%
Vitamin B12	2,5 µg	100%
Acid folik	200 µg	100%
L-Arginin	5 g	100%
Përzierje frutash Forever® e lishensuar	220 mg	
Ekstrakt lëkure rrushi, sheqe, vere të kuqe, lëng bodze pluhur, lëng mjedre pluhur, lëng qershie pluhur, lëng manaferre pluhur dhe lëng boronice pluhur		

* RDA%: %-ja e sasisë ditore të rekomanduar për të rriturit



- L-Arginin njihet si “molekula mrekullibërëse”.
- Përmban përzierje frutash të lishensuara me efekt antioksidant.
- Kontribuon në ruajtjen e qarkullimit të shëndetshëm të gjakut.

PRODUCT # 320